



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË

Nr. 92 Prot

Tiranë, më 12 . 05 2021

Lënda: Për miratimin e Programit Vjetor të Financimit dhe Skemës së Shpërndarjes së Fondit Grant

ZNJ. EVIS KUSHI
MINISTËR
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Rr. "Durrësit" Nr. 22, Tiranë

E nderuar Znj. Ministre,

Në zbatim të Vendimit nr. 1141 datë 24.12.2020, "Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë" përcjellim pranë jush Programin Vjetor të Financimit dhe Skemën e Shpërndarjes së Fondit Grant për miratim.

Duke uruar punë të mbarë, në pritje të miratimit tuaj.

Faleminderit,

Konceptoi: R.Sana
Kaloi: J.Shamku

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Kleina Kasanai



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË

PËR PROPOZIMIN E PROGRAMIT VJETOR TË FINANCIMIT DHE SKEMËN E SHPËRNDARJES SË FONDIT GRANT

I. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Nëpërmjet këtij propozimi synohet të arrihet programi vjetor i financimit dhe skema vjetore e shpërndarjes së fondit grant të dedikuar për financimin e projekteve rinore, parashikuar në pikën 8, 9 dhe 10 të VKM nr. 1141 datë 24.12.2020, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë” dhe pikën III/4/ç të VKM nr. 681, datë 02.9.2020 “Për mënyrën e krijimit, të organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë (AKR)”

Referuar misionit që do të përmbushet, programi i financimit dhe skema vjetore e shpërndarjes së fondit organizohen në funksion të maksimit të rezultatit përfundimtar të impaktit të rinjtë.

II. SKEMA VJETORE E SHPËRNDARJES SË FONDIT

Pas konsultimit me Këshillin Kombëtar të Rinisë skema e shpërndarjes së fondit të jetë si vijon:

Për organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë, shpërndarja e fondit do të jetë në 3 (tre) këste:

1. Kësti I, 50% e vlerës së financimit menjëherë pas shpalljes fitues të projektit.
2. Kësti II, 40% e vlerës së projektit menjëherë pas përfundimit dhe vlerësimit pozitiv mbi realizimin e fondeve të kështit I.
3. Kësti III, 10%, e vlerës së projektit në përfundim të projektit, pas përfundimit dhe vlerësimit të suksesshëm të projektit.

Për njësitë e vetëqeverisjes vendore, shpërndarja e fondit do të jetë në 2 (dy) këste:

1. Kësti I, 90% e vlerës së financimit menjëherë pas shpalljes fitues të projektit.
2. Kësti II, 10%, e vlerës së projektit në përfundim të projektit, pas përfundimit dhe vlerësimit të suksesshëm të projektit.

II. PROGRAMI I FINANCIMIT PËR ORGANIZATAT DHE/OSE PËR TË RINJTË DHE NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE

Projektet që do të mbështeten financiarisht nga ky Grant do të zbatohen ekskluzivisht në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Pas konsultimit me Këshillin Kombëtar të Rinisë të hapen 2 (dy) thirrje, 1 (një) drejtuar organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë dhe 1 (një) thirrje drejtuar njësive të vetëqeverisjes vendore.

Shuma totale e financimit do të zbatohet referuar kapacitetit dhe përfshirjes në projekte dhe programe me impakt të rinjtë.

Thirrja drejtuar organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë:

- 20% e fondit grant vjetor të parashikuar do të financojë projektet e propozuara nga organizatat rinore. Shuma maksimale e financimit për projekt-propozim do të jetë 1.000.000 lekë.
- 40% e fondit grant vjetor të parashikuar do të financojë projektet e propozuara nga organizatat për të rinjtë. Shuma maksimale e financimit për projekt-propozim do të jetë 3.000.000 lekë.

Kostot administrative (qera zyre, mirëmbajtje zyre, energji elektrike(OSHEE), ujë (UKT), paga e stafit dhe drejtuesit të projektit) nuk mund të kalojnë 25% të vlerës totale të buxhetit.

Thirrja drejtuar njësive të vetëqeverisjes vendore:

- 40% e fondit grant vjetor të parashikuar do të financojë projektet e propozuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Afatet, procedura dhe detyrimet e organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë dhe njësive të vetëqeverisjes vendore:

- Thirrjet do të hapen me një shumë maksimale dhe kohëzgjatja e zbatimit të projektit do të jetë në afatet nga 6 (gjashtë) deri në 12 (dymbëdhjetë) muaj.
- Afatet e dorëzimit të aplikimeve do të jenë 45 (dyzetë e pesë) ditë kalendarike nga data e shpalljes së thirrjes për projekt-propozime.
- Vlerësimi i projekt-propozime dhe shpallja e rezultatit do të jetë 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga e nesërmeja pas përfundimit të afatit 45 (dyzetë e pesë) ditor.
- Kandidatët njoftohen brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike pas përfundimit të vlerësimit të rezultateve të konkurrimit.
- Kontrata mes AKR-së dhe kandidatit përfitues nënshkruhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e shpalljes së njoftimit të rezultatit të konkurrimit.

- Grantmarrësi detyrohet që të gjitha pagesat mbi shumën 30.000 lekë ti kryejë nëpërmjet llogarisë bankare (transfertë bankare ose çek bankar). Nuk do të njihen pagesat nga arka për shuma mbi 30.000 lekë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Rinisë bëhet në zbatim të ligjit nr.75/2019, “Për rininë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 681, datë 02.9.2020 “Për mënyrën e krijimit, të organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë (AKR)” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1141, datë 24.12.2020 “, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë”.

PROPOZUESI
DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KLEINA KASANAJ

